



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 2718/Prot.

Tiranë, më 12.11.2025

VENDIM

Nr. 343, Datë 03.11.2025

**“PËR MIRATIMIN E VEPRIMTARISË JASHTË FUNKSIONI TË PROKURORIT
ALBJONA PAPAJANI”**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i përbërë nga:

1. Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Erind GERMENJI	Zv/kryetar
3. Sokol STOJANI	Anëtar (në mungesë)
4. Zeqir HODA	Anëtar
5. Arta MANDRO	Anëtar (në mungesë)
6. Ledina RIZA	Anëtar
7. Moisi DUDA	Anëtar
8. Vatë STAKA	Anëtar (në mungesë)
9. Olger EMINAJ	Anëtar
10. Erind MERKURI	Anëtar (në mungesë)
11. Erion FEJZULLA	Anëtar

Në mbledhjen e datës 03.11.2025, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 159-161, 164 dhe vijues të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenet 18 e vijues, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Për miratimin e veprimtarisë jashtë funksioni të prokurorit Albjona Papajani”

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Pasi mori në shqyrtim Relacionin shoqërues nr. 2718 prot., datë 30.10.2025, të Komisionit të Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit, dëgjoi Relatorin Erion Fejzulla, si dhe referuar bazës ligjore të lartpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,

V Ë R E N:

1. Pranë Këshillit është administruar me nr. 2569 prot., datë 20.10.2025, Kërkesa e magjistratit Albjona Papajani, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, si dhe informacioni shtesë përmes e-mailit zyrtar të datës 29.10.2025, për kryerjen e veprimtarisë me pagesë jashtë funksioni të prokurorit.
2. Prokurorja Albjona Papajani ka parashtruar kërkesën për tu angazhuar si lektore e jashtme për lëndët penale, për kursin në nivelin "Master", në Akademinë e Sigurisë. Realizimi i veprimtarisë jashtë funksioni do të bëhet gjatë vitit akademik 2025-2026.
3. Veprimtaria jashtë funksionit është parashikuar për t'u përmbushur jashtë orarit zyrtar të punës, pas orës 16:00.
4. Pagesa për këtë veprimtari do të jetë në përputhje me tarifat e miratuara nga Vendimi nr 748 datë 11.06.2009 *"Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë"*, i ndryshuar, i Këshillit të Ministrave.
5. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur, Komisioni i Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit konstatoi se, prokurorja Albjona Papajani nuk është subjekt i ndonjë procedimi disiplinor dhe nuk ka masa disiplinore në fuqi.
6. Ushtrimi i veprimtarisë jashtë funksionit në masën dhe kohën sipas kërkesës së paraqitur nuk ndikon negativisht në ushtrimin e detyrës së saj.
7. Veprimtaria jashtë funksionit në rastin konkret:
 - është në përputhje me dinjitetin e ushtrimit të funksionit;
 - nuk është e papajtueshme me ushtrimin e funksionit të magjistratit dhe nuk ndalohej sipas ligjit.
 - nuk krijon perceptime të ndikimit ose njëanshmëri gjatë ushtrimit të funksionit;
 - nuk bie ndesh me interesat thelbësorë të funksionit, duke mos cenuar afatet dhe ushtrimin në mënyrë efikase të funksioneve.
8. Për sa më sipër, Komisioni i Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit i propozoi Këshillit miratimin e kërkesës së prokurores Albjona Papajani për të qenë lektor i jashtëm për lëndët penale, në vitin akademik 2025-2026, në Akademinë e Sigurisë.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 149/a, pika 1, germa “e” dhe 149/ç, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, në nenin 9, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në nenet 164, pika 8, 166 dhe 189, pika 1, germa “a”, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, dhe në nenin 8, të Rregullores “Për veprimtaritë jashtë funksionit të prokurorëve”, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e veprimtarisë jashtë funksioni për prokurorin Albjona Papajani, si lektor i jashtëm për lëndët penale, në vitin akademik 2025-2026, në Akademinë e Sigurisë.
2. Të njoftohet për këtë vendim Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe prokurori Albjona Papajani.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë sot më 03.11.2025.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR
Mirela Bogdani

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Olger Eminaj

ANËTAR
Ledina Riza

ANËTAR
Erion Fejzulla

ZV/KRYETAR
Erind Gërmenji

ANËTAR
Moisi Duda